



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHERBIMIT CIVIL

Rr "Abdi Toptani" ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142 ; 22268141

Nr. 539/8 prot.

Tiranë 21.03.2017

V E N D I M
Nr.59 datë 21.03.2017

Për përfundimin e hetimit administrativ filluar me
Urdhërin e Verifikimit nr. 539 prot., datë 02.09.2016

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 35, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr. 77 prot., datë 08.03.2017, mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në ecurinë disiplinore ndaj punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, *****.

V e r e j s e:

Në zbatim të Urdhërit nr. 539 prot., datë 02.09.2016, ka filluar hetimi administrativ në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë, së veprimeve administrative të Komisionit të Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në nxjerrjen e aktit administrativ "Vendim i Ndërmjetëm" nr. 16763/1 prot., datë 04.07.2016, me të cilin është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës për nëpunësin *****.

Shkak për fillimin e kësaj procedure është bërë një ankesë e paraqitur nga nëpunësi ***** , protokolluar pranë Komisionerit, me nr. 522 prot., datë 16.08.2016, përmes së cilës ngrihet pretendimi se ndaj tij, në shkelje flagrante të ligjit, është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës. Në kërkesë është parashtruar se nga ana e Komisionit Disiplinor të ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar , si dhe të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në

Komisionin Disiplinor në shërbimin civil". Konkretisht, pretendohet se atij i është mohuar e drejta për t'u njohur me shkeljen disiplinore të pretenduar dhe klasifikimin e saj, e drejta për t'u informuar lidhur me shkeljet faktike të pretenduara dhe aktet shkresore që provojnë kryerjen e tyre. Gjithashtu nuk është respektuar e drejta e tij për t'u dëgjuar, për t'u përfaqësuar me avokat, apo të mbrohet përmes provave shkresore dhe dëshmitarëve.

Pas shqyrtimit paraprakisht të kërkesës lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, janë njoftuar nga ana e Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Departamenti i Administratës Publike, për fillimin e verifikimit të informacionit.

Nga aktet e administruara gjatë procesit të verifikimit, rezultoi se, në datën 30.06.2016, punonjësi ***** , së bashku me tre specialistë të tjerë të Drejtorisë së Hetimit, janë urdhëruar të ushtrorjnë kontroll në pikën doganore "*Tre Urat Përmet*". Gjatë kryerjes së detyrës ata konstatuan se, dy mjete me targa AA374DR dhe AA259KC, po tentonin të kryenin veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore në fushën doganore. Grupi hetimor ka informuar menjëherë sektorin e monitorimit pranë DOH-së (*Drejtoria Operative Hetimore*), për rastin në fjalë dhe ka marrë konfirmimin për ndjekjen e dy mjeteve të dyshuara me qëllim evidentimin dhe goditjen e kontrabandës. Gjatë ndjekjes së mjeteve, ata u ndaluan nga autoritetet e shtetit Grek, të cilët ngritën ndaj tyre akuzat se ata ishin anëtarë dhe pjesëmarrës të një organizate të strukturuar kriminale, e cila kryente grabitje me qëllim përfitimi, si dhe mosbindje ndaj organeve policore. Ndërkohë, Gjykata e Shkallës së Parë Janinë, me Vendimin nr. 816/2016 prot., datë 05.07.2016, pas shqyrtimit të fakteve dhe provave të dosjes hetimore, ka vendosur lirin e menjëhershëm të tyre pa asnjë kusht kufizimi.

Me shkresën nr. 16763 prot., datë 01.07.2016, Drejtori i Drejtorisë Hetimore ka njoftuar Komisionin e Disiplinës se, në rrugë jo zyrtare është vënë në dijeni të faktit se grupi hetimor në përbërje të të cilit ishte dhe punonjësi ***** është ndaluar në Janinë, nga policia Greke.

Komisioni i Disiplinës, bazuar në pikën 6, të nenit 59, të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, me vendimin nr. 16763/1, datë 04.07.2016, ka urdhëruar fillimisht, pezullimin nga ushtrimi i detyrës të nëpunësit civil ***** . Më tej, me vendimin e ndërmjetëm nr. 16763/23, datë 16.09.2016, është urdhëruar shfuqizimi i pikës 1, të vendimit të ndërmjetëm nr. 16763/1 prot., datë 04.07.2016, duke hequr masën e pezullimit nga ushtrimi i detyrës për nëpunësin ***** dhe vijimësinë e ecurisë disiplinore derisa të merret një informacion zyrtar mbi statusin juridik të këtij nëpunësi, në procesin që po zhvillohet dhe po ndiqet prej organeve kompetente greke, prokurorisë dhe/ose Gjykatës së Shkallës së parë Janinë.

Gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u kërkua kohë, për të thelluar hetimin administrativ, pasi me materialet që përmbante dosja hetimore, nuk mund të dilnin me një vendim përfundimtar. Duke qenë se, organi disiplinor, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, duhet të hetojë kryesisht të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e ngjarjes të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit, Komisioneri e gjeti të mbështetur në ligj kërkesën e Komisionit Disiplinor për të kapërcyer afatet e përcaktuara në vendimin nr.115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*". Për këtë arsye me vendimin e ndërmjetëm nr. 116, datë 08.11.2016, Komisioneri vendosi të pezullojë hetimin administrativ të nisur me urdhrin e verifikimit nr. 539

prot., datë 02.09.2016, derisa Komisioni Disiplinor i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të dalë me një vendim përfundimtar.

Më pas, pranë Komisionerit ka ardhur shkresa me nr. 25713 prot., datë 03.11.2016, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përmes së cilës është kërkuar, një interpretim lidhur me klasifikimin e disa pozicioneve të punës, të cilat janë trajtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe DAP si pjesë e shërbimit civil, ku midis pozicioneve të kërkuara bëhej fjalë edhe për pozicionin e kërkuesit.

Komisioneri, pasi u konsultua me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat përcaktojnë raportin me shërbimin civil, për disa pozicione të kërkuara në mënyrë specifike, sipas emërtesave të tyre, i është përgjigjur me shkresën nr. 651/1 prot., datë 23.11.2016. Nëpërmjet kësaj shkrese, është orientuar Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndër të tjera edhe për trajtimin që duhet t'i bëhet punonjësve të cilët kanë atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore, duke referuar nenin 2/h, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe nenit 7/4, të ligjit nr. 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se: *“punonjësit të cilët realizojnë atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore, nuk duhet të jenë pjesë e shërbimit civil”*.

Pas kësaj ndërhyrje të Komisionerit, u miratua Vendimi nr. 9, datë 11.01.2017, i Këshillit të Ministrave, *“Për Personelin e Administratës Doganore”*, i cili në pikën 6 të tij sanksionoi se: *“... punonjësit e Drejtorisë së Hetimit (ku bën pjesë edhe kërkuesi), Drejtorisë së Antikontrabandës dhe Drejtorisë Antitrafik, që kanë atributet e oficerit të Policisë Gjyqësore, trajtohen në përputhje me Kodin e Punës, legjislacionin doganor dhe me legjislacionin specifik”*.

Nga sa cituam më sipër, përcaktohet se pozicioni i punës së punonjësit ***** *“Specialist në Drejtorinë e Hetimit”*, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nuk është pozicion pune pjesë e shërbimit civil, por marrëdhënia e punës, rregullohet nëpërmjet Kodit të Punës.

Nisur nga rrethanat e reja të evidentuara në këtë vendim, pozicioni i punës në fjalë nuk rregullohet nga ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, e për këtë shkak Komisioneri vlerëson se ky hetim administrativ nuk është në fushën e kompetencës lëndore të tij.

Neni 22 i ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përcakton se kompetencat e organeve publike janë të përcaktuara me ligj, dhe ushtrimi i tyre është i detyrueshëm. Gjithashtu neni 23 i po këtij ligji, sanksionon se është në detyrimin e organeve publike verifikimi kryesisht i kompetencës lëndore dhe tokësore.

Për këto arsye:

Në mbështetje të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nenit 7/4, të ligjit nr. 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 11.01.2017, *“Për Personelin e Administratës Doganore”*, si dhe të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të deklarojë përfundimin e hetimit administrativ, të nisur me urdhërin e verifikimit nr. 539 prot., datë 02.09.2016, “Për verifikimin e aktit nr. 16763/1, datë 04.07.2016, të Komisionit Disiplinor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, pasi shqyrtimi i kësaj çështje nuk është në kompetencën lëndore të Komisionerit.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike dhe punonjësi *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA